



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2017 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATAVE TË LICENCIMIT APO REGJISTRIMIT TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare, si dhe të rregullojë procedurën për lëshimin dhe/ose zëvendësimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare.

Neni 2 Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim si në vijim:
 - 1.1. **BQK** – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Certifikatë e licencimit apo regjistrimit** - nënkupton dokumentin e lëshuar nga BQK-ja përmes të cilit vërtetohet se institucioni financiar është licencuar/regjistruar nga BQK-ja për të ushtuar veprimtari financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 1.3. **Institucione financiare** – nënkupton subjektet si banka, kompani të sigurimeve, fonde pensionale, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobanbankare, kompani ndërmjetësuese në sigurime, kompani të trajtimit të dëmeve si dhe subjekte tjera juridike që ushtrojnë aktivitete financiare siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe që licencohen ose regjistrohen, rregullohen dhe mbikëqyren nga BQK-ja.
 - 1.4. **Aneks i certifikatës së licencimit apo regjistrimit** – nënkupton dokumentin që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e certifikatës së licencimit apo regjistrimit në të cilin paraqiten veprimtaritë specifike financiare të lejuara për institucionin financiar.

Neni 3

Lëshimi i Certifikatës së Licencimit apo Regjistrimit

1. Pas marrjes së vendimit për miratimin e dhënies së licencës apo regjistrimit në pajtim me dispozitat ligjore, BQK-ja do të lëshojë certifikatën e licencimit apo regjistrimit në dy (2) kopje origjinale, ku njëra i dorëzohet institucionit financiar të licencuar apo regjistruar, ndërsa tjetra mbahet në BQK.
2. Certifikatës së licencimit apo regjistrimit nga paragrafi 1 i këtij neni i bashkëngjitet aneksi i certifikatës së licencimit apo regjistrimit në të cilin specifikohen veprimtaritë financiare për të cilat institucioni financiar është licencuar apo regjistruar nga BQK-ja.

Neni 4

Përmbajtja e Certifikatës së Licencimit apo Regjistrimit

1. Certifikata e licencimit apo regjistrimit duhet të përmbajë elementet si në vijim:
 - 1.1. emri dhe logo e BQK-së;
 - 1.2. numri identifikues i certifikatës dhe data e lëshimit;
 - 1.3. emri i institucionit financiar të licencuar apo regjistruar dhe numri i regjistrimit të biznesit në ARBK;
 - 1.4. lloji i institucionit financiar të licencuar apo regjistruar;
 - 1.5. klauzola për anekse të certifikatës sipas nenit 3, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje;
 - 1.6. vendi i veprimtarisë, nëse ka;
 - 1.7. vula e BQK-së dhe nënshkrimi i personit të autorizuar për të nënshkruar në emër të BQK-së.

Neni 5

Transferimi i Licencimit apo Regjistrimit

Certifikata e licencimit apo regjistrimit e lëshuar nga BQK-ja është e patransferueshme.

Neni 6

Kohëzgjatja e Licencës dhe Regjistrimit

Certifikata e licencimit apo regjistrimit lëshohet për afat kohor të pacaktuar.

Neni 7

Zëvendësimi i Certifikatës së Licencimit apo Regjistrimit

1. Zëvendësimi i certifikatës së licencimit apo regjistrimit mund të bëhet me kërkesë të institucionit financiar ose me iniciativë të BQK-së.
2. Zëvendësimi i certifikatës së licencimit apo regjistrimit me kërkesë të institucionit financiar bëhet në rastet si në vijim:
 - 2.1. humbja e certifikatës;
 - 2.2. dëmtimi i certifikatës,
 - 2.3. ndryshimi i të dhënave që identifikojnë institucionin financiar të licencuar apo regjistruar.
3. Në rast të kërkesës për zëvendësim të certifikatës së licencimit apo regjistrimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, institucioni financiar do të dorëzojë një kërkesë me shkrim për aprovim në BQK.
 - 3.1. Kërkesa duhet të përmbajë si në vijim:
 - 3.1.1. Në rastin nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, kërkesës duhet t'i bashkëngjitet deklarata me shkrim për humbjen e certifikatës;
 - 3.1.2. Në rastin nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, kërkesës duhet t'i bashkëngjitet certifikata e dëmtuar;
 - 3.1.3. Në rastin nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, kërkesës duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni që dëshmon ndryshimin e atyre të dhënave, siç mund të jenë certifikata e regjistrimit të biznesit, vendimet e organeve vendimmarrëse për ndryshimin e të dhënave që identifikojnë institucionin financiar apo të dhëna tjera që BQK-ja i vlerëson të nevojshme për raste specifike.
4. Në rastet nga paragrafi 2, nënparagrafët 2.1 dhe 2.2, të këtij neni, me kërkesë të institucionit financiar të licencuar apo regjistruar, BQK-ja mund të lëshojë edhe kopje të origjinalit të certifikatës së licencimit apo regjistrimit.
5. Kërkesa sipas paragrafit 4 të këtij neni duhet të përmbajë dokumentacionin siç përcaktohet në paragrafin 3, nënparagrafët 3.1.1 dhe 3.1.2, të këtij neni.
6. BQK, me iniciativën e saj, zëvendëson certifikatat e licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare në rastet kur e vlerëson se përmbajtja e tyre është jo e qartë dhe shkakton konfuzion lidhur me identifikimin e institucioneve financiare, siç janë rastet e ndryshimit të emrit të institucionit financiar, rastet e certifikatave të lëshuara nga institucionet paraardhëse të BQK-së (Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës - AQBK dhe Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës – BPK), apo ndonjë rast tjetër.
7. BQK do të vendosë për zëvendësimin e certifikatës së licencimit apo regjistrimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës për zëvendësim.

Neni 8

Dispozita kalimtare

Brenda afatit prej tre (3) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, BQK-ja do të lëshojë certifikata të reja të licencimit apo regjistrimit për të gjitha institucionet financiare. Forma dhe përmbajtja e certifikatave të reja duhet të jetë në pajtim me nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci